

Klasifikimi i ndërmarrjeve dhe detyrimet e raportimit financiar

Udhëzues praktik sipas Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, dhe udhëzimeve të Këshillit Kosovar për Raportim Financiar (KKRF). Ligji hyri në fuqi më 1 janar 2019 dhe zbatohet për periudhën raportuese 2019 e tutje.

1 Si klasifikohet ndërmarrja juaj

Klasifikimi bëhet sipas **tre kriterëve**, të matura në ditën e fundit të vitit të kaluar financiar. Rezultati përcakton kuadrin e raportimit për vitin aktual.

KATEGORIA	TOTALI I PASURISË	QARKULLIMI NETO	TË PUNËSUAR (MESATARISHT)
Mikro	350.000 €	700.000 €	10
E vogël	4.000.000 €	8.000.000 €	50
E mesme	20.000.000 €	40.000.000 €	250
E madhe	tejkalon të paktën dy nga tre kufijtë e ndërmarrjes së mesme (20.000.000 € · 40.000.000 € · 250)		

Rregulli «dy nga tre». Ndërmarrja bën pjesë në një kategori kur **nuk i tejkalon të paktën dy** nga tre kufijtë e saj — pra tejkalmi i vetëm një kriteri nuk e ngre kategorinë. Ndërmarrjet e sapothemeluara klasifikohen sipas të dhënave të vitit të parë, të extrapoluara në baza vjetore. Grupet vlerësohen mbi baza të konsoliduara.

2 Çfarë kërkohet për secilën kategori

KATEGORIA	KUADRI I RAPORTIMIT	SIGURIA MBI PASQYRAT
Mikro	Sipas klasës I, II ose III — shih pikën 3	Nuk kërkohet as auditim as rishikim
E vogël dhe e mesme	SNRF për NVM-të	Qarkullimi deri 4.000.000 € → rishikim Qarkullimi mbi 4.000.000 € → auditim
E madhe dhe SIP	SNK dhe SNRF të plota	Auditim nga firmë e licencuar nga KKRF

Pragu që shumica e bizneseve nuk e dinë. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, vija ndarëse mes **rishikimit** dhe **auditimit** nuk është kategoria, por **qarkullimi vjetor neto prej 4.000.000 €**. Një ndërmarrje e vogël me qarkullim mbi këtë prag i nënshtrohet auditimit të plotë.

Subjektet me interes publik (SIP)

- ✓ Institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
- ✓ Ndërmarrjet publike dhe shoqërore, si dhe shoqëritë që plotësojnë kriteret e të mëdhave
- ✓ Subjektet me letra me vlerë të lejuara për tregtim në një treg të rregulluar

SIP-et i nënshtrohen auditimit pavarësisht madhësisë.

3 Mikro-ndërmarrjet: tre klasa sipas qarkullimit

KLASA	QARKULLIMI VJETOR NETO	PASQYRAT QË PËRGATITEN	KUSH I NËNSHKRUAN
Klasa I	nën 50.000 €	Pasqyra e të ardhurave, me parimin e parasë së gatshme ose atë akrual, sipas zgjedhjes	Drejtori ekzekutiv ose pronari
Klasa II	50.000 – 300.000 €	Pasqyra e pozitës financiare në fund të periudhës dhe pasqyra e të ardhurave, me parimin akrual	Drejtori ekzekutiv/pronari dhe drejtori financiar ose kontabilisti i çertifikuar
Klasa III	mbi 300.000 €	Pasqyra financiare vjetore të plota sipas SNRF për NVM-të	Drejtori ekzekutiv dhe drejtori financiar; nëse ky i fundit nuk është i çertifikuar, edhe kontabilisti i çertifikuar

Pavarësisht klasës, mikro-ndërmarrjet duhet të shpalosin numrin mesatar të të punësuarve gjatë periudhës, totalin e pasurive dhe totalin e detyrimeve në datën e fundit të periudhës, si dhe bazën mbi të cilën janë ndërtuar pasqyrat.

4 Nënshkrimi dhe raportet shtesë

E VOGËL DHE E MESME

Pasqyrat nënshkruhen nga drejtori ekzekutiv ose i përgjithshëm, drejtori financiar ose zyrtari kryesor financiar, dhe/ose kontabilisti i çertifikuar.

Kur qarkullimi kalon 4.000.000 €, bashkëngjitet edhe **deklarata e pajtueshmërisë**, e nënshkruar nga drejtori ekzekutiv dhe zyrtari kryesor financiar.

E MADHE DHE SIP

Nënshkruajnë drejtori ekzekutiv dhe zyrtari kryesor financiar. Nëse ky i fundit nuk është kontabilist i çertifikuar, nënshkruan edhe një kontabilist i çertifikuar nga regjistri publik.

Bashkëngjiten **opinionin i auditimit, deklarata e pajtueshmërisë dhe raportin e menaxhmentit**.

5 Auditim apo rishikim — çfarë ndryshon

	AUDITIM	RISHIKIM
Niveli i sigurisë	Siguri e arsyeshme	Siguri e kufizuar
Standardet	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA/ISA)	Standardet Ndërkombëtare për angazhimet në rishikim (ISRE)
Procedurat	Testim i kontrolleve, konfirmime nga palët e treta, procedura thelbësore	Kryesisht pyetje drejtuar menaxhmentit dhe procedura analitike
Rezultati	Opinion mbi pamjen e drejtë dhe të vërtetë	Konkluzion negativ: nuk kemi vërejtur diçka që tregon se pasqyrat nuk janë të drejta

6 Afatet dhe pasojat

- ✓ **30 prill** i vitit vijues — dorëzimi dhe publikimi i pasqyrave financiare të audituara në KKRF, me një kopje në ministrinë përkatëse për tregti dhe industri
- ✓ **30 qershor** i vitit vijues — pasqyrat financiare të konsoliduara të audituara

Gjobat. Dorëzimi me vonesë ndëshkohet me gjobë fikse sipas kategorisë: **500 €** ndërmarrjet e vogla, **1.500 €** të mesmet, **4.500 €** të mëdhatë. Mosdorëzimi fare: **1.000–20.000 €**. Mosdorëzimi i pasqyrave të audituara: **5.000–10.000 €**. Afati kalon shpejt: auditimi kërkon kohë përgatitjeje, prandaj angazhimi i auditorit në shkurt–mars është zakonisht tepër vonë.

7 Si ju ndihmojmë

Fryti Audit SH.P.K. është firmë e licencuar nga KKRF dhe anëtare e SCAAK, me auditor ligjor në ekip. Përcaktojmë klasifikimin e saktë, përgatisim pasqyrat sipas kuadrit që ju takon, kryejmë auditimin ose rishikimin, dhe kujdesemi që dorëzimi në KKRF të bëhet me kohë.